

A BOOK AT THE SERVICE OF TEACHERS **NJË LIBËR NË SHËRBIM TË MËSIMDHËNËSVE**

Zarije NUREDINI¹

^{1*} *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

**Corresponding author e-mail: zarije.nuredini@unite.edu.mk*

Abstract

Avzi Mustafa is the type of professor who leaves his presence in the life of every student, whether with practical life advice or pedagogical advice for the profession. The professor is known as a sincere, cultured, cooperative and dedicated person. As a rare and incomparable intellectual, he embodies human virtue and ideal at the same time, contributing to the preparation of future generations, who will occupy key positions in schools. As a researcher he is the author of many valuable books from various scientific fields. He felt self-fulfilling whenever he offered professional help to students and colleagues. His life has been associated with teaching and studying. For his work he is appreciated by students, and by the scientific and academic world. His lectures and advice are always there, firmly ingrained in the mind until one day they turn into life experience, as he had planted it, along with pedantry and discipline in professional and scientific work.

Keywords: methodology, didactics, language, reading and word formation.

Përmbledhje

Avzi Mustafa është lloji i profesorit që e le praninë e tij në jetën e secilit student, qoftë me këshilla praktike për jetën, qoftë me ato pedagogjike për profesionin. Profesori njihet si njeri shpirtçiltër, me shumë kulturë, bashkëpunues dhe i përkushtuar. Si njeri i rrallë dhe intelektual i pasohq mishëron virtytin dhe idealin njerëzor njëherazi duke dhënë kontribut në përgatitjen e brezave që vijnë, që do të zënë vendet kyçe nëpër shkolla. Si studiues ai është autori i shumë librave të çmuar nga fusha të ndryshme shkencore. Ai ndjehej i vetëplotësuar sa herë ua ofronte ndihmën profesionale studentëve dhe kolegëve. Jeta e tij ka qenë e lidhur me mësimdhënien dhe studimin. Për punën e tij është i vlerësuar dhe vlerësohet nga studentët dhe nga bota shkencore e akademike. Leksionet dhe këshillat e tija janë përherë aty, të ngulitura fort në mendje derisa një ditë kthehen në përvojë jetësore, ashtu siç e kishte të mbjellur ai, bashkë me pedantërinë dhe disiplinën në punën profesionale e atë shkencore.

Fjalët kyçe: metodika, didaktika, gjuha, leximi dhe fjalëformimi.

Hyrje

Studimet e prof. dr. Avzi Mustafës nga sfera e albanologjisë dhe pedagogjisë janë të shkruar me gjuhë të qartë, të argumentuar dhe dallohen për sa i përket metodologjisë shkencore bashkëkohore. Si të tilla, këto studime, mbeten referenciale për studiuesit e këtyre fushave shkencore. Kur shkruhet për prof. dr. Avzi Mustafën patjetër duhen kapur disa përmasa nga jeta e tij profesionale, qoftë si pedagog apo si studiues. Si pedagog ai është dalluar për zbatimin e metodave më të reja të ligjërit, kurse si studiues është dalluar për zbatimin e metodologjive studimore bashkëkohore, që studimeve të tij u japin peshë të madhe në botën shkencore.

Veprimtaria studimore e prof. dr. Avzi Mustafës është shumëdimensionale dhe, si e tillë, kërkon studime të shumta. Vepra e tij mund të shikohet nga këndvështrime të shumta. Profesor Avzi Mustafa, krahas punës së frytshme pedagogjike dhe arsimore, ka dhënë një ndihmesë të madhe në organizimin dhe mbarëvajtjen e punës së Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë hqiptare të Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Shkupit. Gjithashtu, ka qenë ligjërues dhe ka dhënë ndihmesë të madhe edhe në Universitetin e Tetovës.

Përgatitja e tij e shkëlqyeshme profesionale dhe pedagogjike dëshmohej edhe nga tekstet e tij mësimore për arsimin parauniversitar e universitar. Përgjithësisht, shkrimet e tij i përshkon profesionalizmi, përkushtimi, korrektësia, qartësia, njohja e thellë dhe zbatimi metodologjisë së punës shkencore, si dhe i mundësive shprehëse të shqipes. Në këtë studim jemi fokusuar te libri *Didaktika e gjuhës dhe e leximit letrar (Mustafa, 2004)*, i cili i përket një disipline pedagogjike mbi përvetësimin e gjuhës dhe të letërsisë në shkollë.

Në literaturën shqiptare më së shumti mungojnë botimet nga fusha e metodikës së mësimin të gjuhës amtare, në të gjitha shkallët e arsimit. Është paradoks se fushës më të rëndësishme në sferën e arsimit dhe të kulturës, për çudi, i kemi kushtuar kujdes të paktë. Si rrjedhim, hetohet qartë mungesa e studimeve dhe e literaturës në gjuhën shqipe lidhur me trajtimin e çështjeve të metodikës e të metodologjisë së mësimin të gjuhës amtare.

Në librin e sipërpërmendur, autori i ka shtjelluar çështjet më të rëndësishme nga fusha e metodikës së gjuhës amtare. Ai merret me problemet e përgjithshme të kësaj fushe, nëpërmjet temave: vështrimi panoramik mbi zhvillimin historik të didaktikës së gjuhës shqipe; gjuha shqipe dhe letërsia si shkencë dhe si lëndë mësimore; plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsinë shqipe; kurse pastaj flet për parimet, format, metodat, mënyrat e organizimit të mësimin, duke përfshirë të mësuarit problemor, kërkimor, të diferencuar, të mësuarit të programuar dhe mjetet mësimore në mësimin e gjuhës shqipe etj. Në këtë libër autori ka përfshirë edhe punime me shkrim të nxënësve.

Profesor Avzi Mustafa, në këtë libër, u kushton rëndësi edhe metodikave të veçanta, siç janë: mësimin i morfologjisë (Mustafa, 2004:119), fjalëformimi, pjesët e ligjëratës, metodikës së sintaksës etj (Mustafa, 2004:121-128). Gjithashtu ka përfshirë leximi letrar (Mustafa, 2004:147), temat e të interpretimit letrar të gjithë gjinive letrare, si dhe llojet e krijimeve me karakter popullor, informativ e shkencor (Mustafa, 2004:164). Po ashtu, në libër janë përfshirë edhe temat për sa i përket organizimit të mësimin, organizimit të orës mësimore, llojeve dhe detyrave të shtëpisë etj (Mustafa, 2004:210). Libri përmbyllet me çështjen e analizës së orës mësimore, me qëllim që studentët ta përcjellin zhvillimin dhe analizën e orës mësimore (Mustafa, 2004:211).

Libri i prof. dr. Avzi Mustafës është ndihmesë e madhe jo vetëm për studentët dhe profesorët e gjuhës shqipe, por edhe për të gjithë ata që merren me studimin e kësaj disipline. Ai ka arritur të na jep zgjidhje për probleme të shumta metodike që lidhen me mësimin e gjuhës amtare. Si i tillë, ky libër, studentëve do t'ju shërbejë si model orientimi nga do të nisin me kërkime të mëtejshme për ta zgjeruar horizontin e njohurive që drejtpërdrejt luajnë rol në punën e tyre të suksesshme në profesionin e mësuesisë.

Ky tekst universitar është vlerësuar edhe nga prof. dr. Remzi Nesimi. Ai shkruan se *Didaktika e gjuhës dhe leximit letrar* është tekst universitar për studentët që e studiojnë gjuhën dhe letërsinë shqiptare. Me lëndën e pasur dhe me tematikën e llojllojshme, ky tekst, do t'ju shërbejë edhe gjithë mësimeve, përkatësisht në lëndën e gjuhës shqipe të ciklit të lartë të shkollave të lartë, madje edhe profesorëve të gjuhës shqipe të shkollave të mesme (Mustafa, 2004:212).

Përfundimi

Sot, ndonëse në pension, ai merret aktivisht me shkencë, me një përkushtim të pashoq. Falë kërkimeve të shumta studimore, ia ka bërë të ditur lexuesit shumë emra të harruar dhe të rëndësishëm për kulturën dhe historinë tonë. Ai ka botuar studime për personalitete dhe ngjarje të rëndësishme nga kultura dhe historia shqiptare, që nuk kanë qenë të njohura për lexuesin shqiptar. Kështu ka hapur dyer të reja për studime tjera mbi temat që i ka prekur për herë të parë.

Referencat

- [1]. Mustafa, A., (1995) *Figura mesuesish shqiptar I*, Bksh, Tetovë.
- [2]. Mustafa, A., (1998) *Lidhja e gjuhës me letërsinë në shkollë*, Shqyrtime albanologjike, nr 4.
- [3]. Mustafa, A., (1997) *Edukimi dhe arsimimi nëpër shekuj*, Shkupi, Shkup.
- [4]. Mustafa, A., (1998) *Zhvillimi i shkollimit fillor në gjuhën shqipe në Maqedoni nga viti 1945 deri më 1975*, botim i Logos-A, Shkup.
- [5]. Mustafa, A., (2006) *Didaktika e gjuhës shqipe dhe leximit letrar*, Logos-A, Shkup.
- [6]. Mustafa, A., (2006) *Ejani të mësojmë shqip*, Prosvetno dello, Shkup.
- [7]. Mustafa, A., (2011) *Metodologjia e kërkimeve shkencore në fushë të filologjisë*, Menora, Shkup.
- [8]. Mustafa, A., (2008) *Variacionet gjuhësore*, Menora, Shkup.
- [9]. Mustafa, A., (1995) *Libër leximi per klasën III të shkollave tetëvjeçare*, Prosvetno dello Shkup.